



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 853/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përbarimore të kreditorit “A...” Sh.p.k, me seli në rr. “...– Prishtinë, ndaj debitorit Komuna e Prishtinës, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.733/2020 të datës 21.10.2020, të Përbaruesit Privat Eset Murati me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 20.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Komuna e Prishtinës, i paraqitur kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.733/2020, të datës 21.10.2020, të Përbaruesit Privat Eset Murati, me seli në Prishtinë.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përbarimor P.nr.733/2020, i datës 21.10.2020, i lejuar nga Përbaruesi Privat Eset Murati, me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat Eset Murati, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “A...” Sh.p.k, në bazë të titullit ekzekutiv, Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike IV.EK.C.nr.629/16, të datës 01.03.2019 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ae.nr.179/2019, të datës 16.09.2020, ka nxjerrë urdhrin përbarimor P.nr.733/2020, të datës 21.10.2020, me të cilin ka caktuar zbatimin e përbarimit ndaj debitorit Komuna e Prishtinës dhe ka detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh t’ia paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 2,266,271.30 €, së bashku me kumatën sipas normës vjetore prej 8%, duke llogaritur nga data 05.03.2018, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës

përmbareme në përputhje me Udhëzimin Administrativ MD-Nr.06/2014, me përmbaremin e mjeteve monetare në llogaritë bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogarinë e përmbareuesit privat, me regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe përmbushjen e kredisë së kreditorit nga shitja e tyre dhe pagesa të bëhet në llogarinë bankare të Përmbareuesit Privat Eset Murati, me numër, pranë Bankës

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se urdhri për përmbareim është lëshuar duke e bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike IV.EK.C.nr.629/16, të datës 01.03.2019 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ae.nr.179/2019, i datës 16.09.2020, ndaj të cilave debitori ka paraqitur Revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës. Ka shtuar se në propozimin për përmbareim të parashtruar nga kreditori, nuk mund të kuptohet se për cilat forma të dëmit kërkohet përmbushja e detyrimit, nëse kërkesa është për kompensimin e dëmit apo fitimin e humbur, sepse parashtrësia nuk i paraqet në mënyrë të qartë dhe të saktë shumat për secilën kategori të gjykuar. Tutje ka shtuar se Aktgjykimet e lartcekura nuk janë të argumentuara në aspektin e bazës juridike ngase janë të bazuara vetëm në Vendimin e Ministrisë së Administratës së Pushtetit Lokal dhe si të tilla nuk mund të jenë vendime të qëndrueshme, andaj është e domosdoshme që për këtë çështje të pritet deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Supreme e Kosovës. Gjykatës i ka propozuar që të caktohet seancë publike për të kuptuar kërkesën e kreditorit meqë shuma e kërkuar në formë të përgjithësuar nuk mund të jetë objekt përmbareimi pa u saktësuar të gjitha kërkesat dhe format e gjykuara sipas Aktgjykimit dhe ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të shfuqizohet urdhri përmbareimor, ndërsa lënda të kthehet te kreditori për korrigjim të propozimit të përmbareimit duke përcaktuar format e secilit dëm.

Kreditori në përgjigje në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se prapësimi i debitorit nuk përmban asnjë nga shkaqet e përcaktuara në nenin 71 të LPP-së dhe se prapësimi është paraqitur me qëllim të prolongimit të çështjes. Ka theksuar se procedura përmbareimore është inicuar mbi bazën e Aktgjykimit të formës së prerë i cili ka vulën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë. Gjykatës i ka propozuar që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar dhe urdhri përmbareimor P.nr.733/20, i datës 21.10.2020, të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përbarues ka lejuar përbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përbarimor, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike IV.EK.C.nr.629/16, të datës 01.03.2019, i ndryshuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë Ae.nr.179/2019, të datës 16.09.2020, i formës së prerë nga data 16.09.2020 dhe i ekzekutueshëm prej datës 14.10.2020, në bazë të së cilit përbaruesi privat ka lejuar përbarimin dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenit 23 par.1 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përbarues sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Sipas dokumentit përbarues (titullit ekzekutiv), Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike IV.EK.C.nr.629/16, të datës 01.03.2019, i ndryshuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë Ae.nr.179/2019, të datës 16.09.2020, debitori është detyruar që në emër të borxhit kreditorit t’ia paguaj shumën prej 2,266,271.30 €, së bashku me kamatëvonesën e llogaritur sipas normës vjetore prej 8%, nga data 05.03.2018, e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit.

Gjykata gjeti se dokumenti përbarimor, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike IV.EK.C.nr.629/16, i datës 01.03.2019, i ndryshuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë Ae.nr.179/2019, të datës 16.09.2020, është i

përmbarueshëm ashtu siç përcaktohet në nenin 24 par.1 të LPP-së: *“Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përmbarueshem po që se ka marrë formë të prerë, si dhe po që se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare”*, ngase i njëjti është bërë i formës së prerë nga data 16.09.2020 dhe i ekzekutueshëm prej datës 14.10.2020, dhe i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që në të janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, objekti, mjetet, si dhe shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike IV.EK.C.nr.629/16, i datës 01.03.2019, i ndryshuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë Ae.nr.179/2019, të datës 16.09.2020, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të këtij neni, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, ngase Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike IV.EK.C.nr.629/16, i datës 01.03.2019, i ndryshuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë Ae.nr.179/2019, të datës 16.09.2020, është dorëzuar në origjinal dhe përmban klauzolën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se i njëjti ka parashtruar revizion në Gjykatën Supreme, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk gjejnë mbështetje ligjore ngase në nenin 213 të LPK –së, është përcaktuar se: *“Revizioni i paraqitur nuk është pengesë për përbarimin e aktgjykimit të formës së prerë të goditur”*. Andaj fakti se debitori ka parashtruar revizion nuk paraqet pengesë për ekzekutimin e aktgjykimit të formës së prerë.

Më tej gjykata vlerëson se pretendimet e debitorit lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së dokumentit përmbarues nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përbarimore prandaj dhe nuk

mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08 L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë
Departamenti për Çështje Ekonomike
KPPP.nr.853/22, datë 20.09.2022

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.